

Komuna e Medvegjës

Emblema e komunës



Informacione të përgjithshme

Lokacioni	Jugu i Serbisë – Rajoni i Jabllanicës
Pozicioni gjeografik	42° 50' 21" H - 21° 34' 60" E
Sipërfaqja	524km ² – 45.1% tokë pyjore, 54.9%
Popullata (2002)	10.760
Numri i vendbanimeve	42
Kodi postar	16240

Lokacioni



Rajoni i Serbisë jugore dhe rajoni i Jabllanicës, të cilit i përket komuna e Medvegjës, gjendet në qendër të pjesës jugore të Gadishullit Ballkanik. Kufizohet me rajonin e Pçinjës në jug, Kosovën në perëndim dhe Bullgarinë në lindje. Rajoni në veri kufizohet me rajonin e Nishit, Toplicës dhe të Pirotit.

Në rajon dominojnë dy lugina – e Leskocit (2250 km²) dhe e Vrajës (900 km²), të lidhura me grykën e Gërdelicës (30 km e gjatë dhe 550m e thellë). Rajoni mbulon territorin prej 6289 km², përbëhet nga dy qarqe (i Pçinjës dhe i Jabllanicës) dhe 13 komuna. Sipërfaqja e përgjithshme përbënë 7% të sipërfaqës së përgjithshme të Serbisë.

Komuna e Medvegjës shtrihet në sipërfaqe prej 524,23 kilometra katror, në përbërje të së cilës janë 34 bashkësi lokale me 42 vendbanime në 39 komuna kadastrale me gjithsej 10.760 banorë, sipas regjistrimit të popullatës nga viti 2002. Vlerësimi i dendësisë së popullsisë është 20,52 banorë për një kilometër katror. Nga sipërfaqja e përgjithshme e komunës 54,1% është tokë pyjore, ndërsa 45,9% është tokë bujqësore. Në fshatra jetojnë 7.382 banorë, ndërsa në pjesën urbane të Medvegjës jetojnë 3.378 banorë.

Komuna i përket grupit të komunave kodrinore-malore me 95% të terrenit të tillë. Shumica e vendbanimeve në territorin e komunës nuk janë të lidhura me rrjet adekuat rrugor me selinë e komunës. Nëpër Medvegjë kalon rruga magjistrale Leskoc – Prishtinë, ndërsa me rrugë të asfaltuar me selinë komunale janë të lidhura vendbanimet: Banja e Sijarinës, Gazdari, Leci, Gajtani, Tullari, Retkoceri, Sponca, Tupalla, Borovci, Buçumeti dhe Stublla.